



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna – Suharekë / Opština Suva Reka / Municipality of



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY OF SUHAREKË			
MARRE NË DORËZIM - PRILUJENO RECEIVED			
Nënda org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Brel Number	Bhjeshta Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	170	35086	2

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E  
REKOMANDIMEVE**

**Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra  
Kombëtare e Auditimit për vitin 2019**

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtarët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1.	<p><b>2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit</b></p> <p><b>Çështja B1 – Keq klasifikimi i shpenzimeve</b></p>	<p>Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojë. Siç kemi paraqitur të theksimi I çështjes, komuna ka paguar 489,208€ nga kategoria e investimeve kapitale për mallra dhe shërbime si dhe 7,777€ nga kategoria</p>	<p><b>Rekomandimi B1</b></p> <p>Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.</p>	<p>Zyrtari përgjegjës për përgatitjen e planifikimit të buxhetit të organizatës buxhetor, përgjegjësit e programeve buxhetore dhe Kryetari i komunës kanë forcuar kontrollin aq sa është e lejuar nga ndarjet buxhetore mbështetur në qarkoret buxhetore nr 1 dhe 2 kanë planifikuar buxhetin në mënyre dhe mbi bazën vlerësuar</p>	<p>-Drejtorja për Ekonomi Financa dhe Buxhet</p> <p>-Drejtorja e Arsimit</p> <p>-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale</p> <p>- Udhëheqësit e programeve buxhetore</p>	<p>Faza e parë para datës 30.09.2020</p> <p>-Faza e dytë para datës 30.01.2021</p>	

		<p>e mallrave dhe shërbimeve për investime kapitale. Sipas komunës këto janë pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime, të cilat janë të domosdoshme, andaj dhe ishin aprovuar me ligjin e buxhetit.</p>		<p>sipas nevojave me fokus te veçanet aty ku është e lejueshme dhe e mundshme që projekte e cekura në të gjeturat të paguhen nga kategoria mallrave dhe shërbimeve me qëllim te eliminimit apo te reduktimit te tolerueshëm te keq klasifikimeve. Dhe te gjitha shpenzimet të evidentohen sipas kategorive gjegjëse</p>			
2.	<p><b>Çështja A1 –</b> Mos verifikimi i pronave tatimore</p>	<p>Komuna nuk ka arritur të kryej verifikimin e së paku 20% të pronave të paluajtshme, siç kërkohet me Ligjin</p>	<p><b>Rekomandimi A1</b> Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale do të bëhet ashtu</p>	<p>Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet ka dizajnuar</p>	<p>-Drejtoria për Ekonomi e Financa dhe Buxhet-zyra e tatimit</p>	<p>Faza e parë shtator 2020  -Faza e dytë do të vijoj deri në arritjen dhe</p>	

	<p>për tatimin në pronën të paluajtshme Nr. 06/L-005.</p> <p>Komuna në vitin 2019, prej 14,800 pronave të regjistruara kishte arritur të kryej verifikimin e vetëm 2,379 apo 16% të pronave të paluajtshme.</p> <p>Sipas zyrtarëve komunal mosverifikimi i pronës kishte ndodhur në mungesë të pajisjes me kohë më teknologjitetë re të nevojshme për përkrahje të sistemit të ri të tatimit në pronë dhe nevojës për pajisje me teknologjitetë re për verifikim të pronave.</p>	<p>siç parashihet me ligj duke bërë verifikimin e pronave së paku 20% në vit, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara, që rezultojn me të hyrat e sakta komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.</p>	<p>veprimet në pajtueshmëri me rregullat që rrjedhin nga neni 5 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi tatimin në pronën e paluajtshme nr. 06-L005 që veprimtaria inspektuese të kryhet çdo vitë të paktën 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës së Suharekës. Situata e krijuar lidhur me përhapjen e pandemisë reduktimit të stafit punues dhe masave të marra nga qeveria për menaxhimin e situatës së pandemisë Covid-19,</p>	<p>në pronë</p> <p>Zyra për informim si dhe zyrtar tjerë relevant që janë të angazhuar në këtë proces.</p>	<p>tejkalimin e parashikimeve për inspektimin dhe vetë deklarin e pronave që duhet të taten dhe procedohen në regjistrin e tatimit në pronë.</p>	
--	--	--	---	--	--	--

				<p>objektivat të parashikuar vështrë që munde të realizohen.</p> <p>Po ashtu në vijim do të fillojmë një fushata sensibilizuese që përmes mjeteve të informimit shpërndarjes së fletushkave materialeve tjera relevante për sensibilizimin e qytetarëve që posedojnë pronë të paluajtshme e cila nuk është regjistruar në regjistrat e tatimit në pronë .Tutje regjistrimi duhet të bëhet duke aplikuar</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>procedurat e vetë deklarimeve në Komunë duke i siguruar informacione të nevojshme në lidhje me pronën e pa luajtshme dhe poseduesin e pronave me së largu deri 31.11. të vitit para vitit tatimore</p> <p>Ndërmarrja e veprimeve nga ana e qytetarëve për vetë deklarimin eliminon rrezikun e mos ballafaqimit me ndëshkime për mos paraqitje të pasurisë për regjistrim në regjistrin e</p>			
--	--	--	--	---	--	--	--

				pronës së paluajtshme mbështetur në nenin 14 pika 3 të ligjit mbi pronën e paluajtshme .			
3.	<b>Çështja A2 –</b> Mos aplikimi i taksës vjetore për shfrytëzuesit e pronës publike komunale.	Sipas kontratës nr. 597 të lidhur me datë 14.10.2009 në mes shfrytëzuesit të pronës publike dhe Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pronës komunale në Zonën Industriale për “Prodhimin e elementeve nga betoni”, palët ishin pajtuar që afati i qiradhënies të jetë 99 vite përkatësisht Neni 2 i kontratës, me një shumë prej 2,450€ në vit e specifikuar në Nenin 3 të kontratës.  Lidhur me këtë, ne kemi identifikuar se komuna nuk kishte bërë ngarkesë vjetore për	<b>Rekomandimi A2</b>  Kryetari i Komunës duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pronave të paluajtshme të dhëna në shfrytëzim, si dhe të sigurojë që çdo prone të ngarkohet me taksë, në përputhje me kushtet dhe hapësirën shfrytëzuese të pronës komunale.	Ne në vijim pas identifikimit të mos ngarkesës me taksë vjetore kemi ndërmarr veprime të menjëhershme dhe gjatë kohës së auditimit qiramarrësi është faturuar menjëherë në mënyrë retroaktive me taksë vjetore që është përcaktuar në kontratë. Edhe gjatë vitit 2020 po ashtu kemi dizajnuar kontrollin dhe	-Drejtoria për ekonomi e Financa dhe Buxhet-Spektori i Financave.  - Drejtoria e Pronës e cila është edhe e autorizuar për menaxhimin e kontratave.	Fillimi i adresimit periodha TM4-2019  -Përcjellja e ecurisë dhe progresit te adresimit përfundon deri në periudhën. 30.06.2020.	Sqarim:Ky rekomandim në bazë të popullimit të testimit të kontratave është adresuar plotësisht.

		<p>shfrytëzuesin e pronës ashtu siç parashihej nëkontratë që nga viti 2014. Kjo kishte ndodhur meqenëse komuna në vitin 2014 kishte formuar një komision për mbikëqyrjen dhe realizimin e kontratave për shfrytëzim të pronës komunale I cili në atë kohë kishte rekomanduar shkëputjen e kontratës në fjalë si rezultat i mos përmbushjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.</p> <p>Në mungesë të ndonjë vendimi nga Kryetari I Komunës për shkëputjen e kontratës, zyrtarët përgjegjës nuk kishin faturuar shumën vjetore për firmën në fjalë, pavarësisht që firma vazhdonte të shfrytëzojë pronën komunale spas kushteve të</p>		<p>kemi identifikuar të gjitha kontratat e nënshkuara janë faturuar në pajtueshmëri me çmimet e përcaktuara në kontratat e nënshkuara dhe ky rekomandim ka filluar të adresohet gjatë vitit 2019 dhe gjatë rishikimit dhe përcjelljes së ecurisë së adresimit të rekomandimit edhe gjatë vitit 2020 konstatojmë se rekomandimi është adresuar në tersi.</p>			
--	--	--	--	---	--	--	--



		kontratës. Pas rekomandimit nga ana jonë komuna kishte ngarkuar retroaktivisht biznesin për periudhën sa nuk ishte ngarkuar.					
4.	<b>2.1.3 Mallrat dhe shërbimet</b>  <b>Çështja C1 – Pranimi I shërbimeve dhe furnizimeve jo sipas rregullave</b>	Sipas nenit 8 pika 4 të Rregullës financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) me vendim duhet të formojë Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare, icili ka përgjegjësi të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar. Ndërsa sipas nenit 7, pika 4 të udhëzimit të brendshëm 01-Nr.7011/1-2008 për përdorimin e automjeteve zyrtare, Komisioni duhet të raportoj në formë të shkruar mbikryerjen e shërbimeve,	<b>Rekomandimi C1</b>  Kryetari duhet të sigurojë që komisionet përkatëse për pranimin e shërbimeve apo furnizimeve janë caktuar me kohë, pranimi I mallrave/shërbimeve e është bërë sipas rregullave të përcaktuara dhe që pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimin.	Ne në vijim do të forcojmë kontrollin me të gjitha njësitë kërkuese të pas porosisë së mallrave dhe shërbimeve paraparakisht të kërkojnë dhe sigurojnë formimin e komisioneve nga ana e Kryetarit të komunës për pranimin e furnizimeve dhe shërbimeve në pajtueshmëri me rregullat që rrjedhin nga neni 8 pika 4 të Rregullores	-Të gjithë Udhëheqësit e njërive kërkuese të programeve buxhetore.	-Faza e par pas dorëzimit të PV tek ZKA .  -Faza e dytë vijon edhe gjatë viteve tjera	

	<p>kualitetin dhe një kopje t' idërgohet edhe zyrës së prokurimit I cili raport bashkëngjitet faturës për ekzekutimin e pagesës për kryerjen e riparimit dhe mirëmbajtjes se automjetit.</p> <p>Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur si ne vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në një rast furnizim me material për zyre në vlerë prej 1,945€ pranimi nuk ishte bërë me vendim e as nga komisioni por ishte bërë nga drejtori I njësisë kërkuese dhe menaxheri I kontratës; dhe</li> <li>Në 2 pagesa me vlerë të përbashkët financiare prej 8,615€ porositja dhe pranimi I shërbimeve për mirëmbajtje dhe riparim të</li> </ul>		<p>financiare nr 02-2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Komisionet do të hartojnë raporte në formë të shkruar për pranimin e furnizimeve dhe gjatë aplikimit të procedurave të lëvizjes dokumentues e si proces zingjiror, dokumentit të pagesës të paiset edhe me raportin e pranimit nga ana e komisioneve. Edhe pse raste të tilla të identifikuar janë shume të pakta. Drejtori për Administratë komunale ka forcuar</p>			
--	---	--	--	--	--	--

		<p>automjeteve ishte bërë nga një person i vetëm, duke mos respektuar kërkesat e udhëzimit të brendshëm.</p> <p>Sipas menaxhmentit, kjo ka ndodhur për shkak se drejtoritë përkatëse nuk i kanë bërë kërkesat me kohë ZKA-së për formim të komisionit për pranim të furnizimeve apo shërbimeve.</p>		<p>kontrollin në vijim për formimin e komisionit i cili komision do të veproj në pajtueshmëri të plotë me zbatimin e rregullave që rrjedhin nga neni 7 pika 7.4 të Udhëzimit për përdorimin e automjeteve zyrtare nr 01-Nr-7011-1 datë 23 Qershor të vitit 2008</p>			
5.	<p><b>2.1.4 Subvencionet dhe transferet</b></p> <p><b>Çështja A3 –</b> Mos dërgimi i planit dheraportit vjetor për miratim, për mbështetje financiarë OJQ-</p>	<p>Rregullorja MF Nr.04/2017 për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve. Neni 6, pika 1 - ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin</p>	<p><b>Rekomandimi A3</b></p> <p>Kryetari duhet të siguroj që plani dhe raporti vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohen në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e përcaktuar me</p>	<p>Edhe pse kontrolli ka funksionuar kishte përgatitur planin vjetor për financimin e OJQ-ve si dhe procedurat tjera që rrjedhin nga</p>	<p>Zyrtarët e autorizuar në këtë sistem</p>	<p>Data e fillimit TM2 2020 dhe afati i mbarimit TM1 2021</p>	

<p>ve, në Zyrën e Kryeministrit</p>	<p><i>pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe / dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mire pranë Zyrës së Kryeministrit.</i></p> <p><i>Komuna kishte përgatitur planin vjetor përfinancimin e OJQ-ve, listën e OJQ-ve, individëve që kanë plotësuar kushtet për vlerësim si dhe vendimin e fitueseve të shpallur. Mirëpo të njëjtin plan si dhe raportin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të për vitin 2019, nuk i kishte dërguar në Zyrën e Kryeministrit ashtu siç kërkohet me rregulloren.</i></p> <p><i>Kjo kishte ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur të</i></p>	<p><i>Ligj.</i></p>	<p><i>Rregullorja MF nr 04-2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve zyrtarët e autorizuar nuk e kanë dorëzuar për procedura tjera planin si dhe raportin vjetor të mbështetjes financiare në zyrën e kryeministrit ashtu siç kërkohet me rregulloren. Në vijim do ta forcojmë kontrollin që pas përgatitjes së pjesës të planit vjetor për mbështetje</i></p>			
-------------------------------------	--	---------------------	--	--	--	--

		zyrtarëve përkatës që këtë plan të dorëzojnë me kohë në Zyrë të Kryeministrit.		financiare të OJQ-ve do ta dërgojnë më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës për procedura të mëtejshme pran zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pran zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës Tutje zyra e Kryeministrit Përgatit planin Vjetor përmbledhës për mbështetje financiare për OJQ-të dhe e publikon në faqen elektronike më së largu në afat prej 45 ditësh pas miratimit			
--	--	--	--	---	--	--	--

				Buxheti të Kosovës.			
6.	<p><b>2.1.5 Investimet kapitale</b></p> <p><b>Çështja B2 –</b> Mos zbatimi i planit dinamik për realizimin e punimeve si dhe mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit të punimeve.</p>	<p>Në kontratat e nënshkuara për Projektet Kapitale Ishin Përcaktuar afatet Kohore për realizimin punëve apo afateve për furnizimin e pajisjeve. ndërsa me rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurimin publik, pika 30.6 specifikohet se, siguria e ekzekutimit mbetet valide për një periudhë tridhjetë (30) ditë pas</p>	<p><b>Rekomandimi B2</b></p> <p>Kryetari duhe të ndërmerr masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe administrative para fillimit të punimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.</p>	<p>Ne në vijim do të forcojmë kontrollin në ndërmarrjen e veprimeve për të gjithë kontaktuesit të cilët nuk i kryejnë punimet sipas planit dinamik në bashkëpunim me organet mbikëqyrëse dhe menaxherët e kontratave pas marrjes së kërkesave për mos respektim të planit dinamik</p>	<p>Menaxherët e projekteve - zyra e prokurimit</p>	<p>Fillimi i implementimit Gusht 2020 dhe planifikimi i përfundimit Dhjetor 2020</p>	

	<p>kompletimit të kontratës.</p> <p>Gjatë testimit ne kemi vërejtur se realizimi i projekteve kapitale kishte vonesa si në vijim:</p> <p>Në projektin "Ndërtimi irrugëve lokale "Perspektiva, Mustafaj, Rrustem Osmani, Dita e Flamurit, Zeqirve - Abazaj, Kovaqit" dhe ndërtimi i urëste lagjja e "Sopaj" në Mushtisht", Komuna kishte nën shkruar një kontratë në vlerë 103,000€ në maj të vitit 2019, ku punët do të duhej të përfundonin brenda 90 ditë. Megjithatë punimet ende nuk kishin përfunduar, e që tregon se vonesat janë afër një vit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në projektin "Ndërtimi i rrugës Freskia (segment),</li> </ul>	<p>Njëherit për projekte që janë në vonesa të realizimit të sigurohet se është kërkuar vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit.</p>	<p>të punës dhe mos vazhdimi të sigurimit të ekzekutimit të kontratës zyra e prokurimit do të ndërmarr veprime të menjëhershme me penalizime ndaj Operatorëve Ekonomik në pajtueshmëri me ligjin e prokurimit dhe ligjeve detyesore të prokurimit si dhe do të i kërkohej OE vazhdimi i validitetit të sigurimit të kontratës në një afat prej 30 ditësh pas kompletimit të projektit mbi bazën e rregullave që rrjedhin nga</p>			
--	--	--	--	--	--	--

		<p>Luk Simoni dhe rrugët lokale në Sallagrahdë" në vlerë 20,840€ e lidhur me datë 30.07.2019, punët do të duhej të përfundonin brenda 60 ditë, ndërsa ende nuk kishin përfunduar punimet, e që paraqet vonesa prej më shumë se gjashtë muaj në realizmin e këtij projekti;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në projektin "Punimi I fushave sportive në fshatin Grajqevc dhe punime tjera rinovuese" në vlerë prej 41,623€ e nënshkruar me 16.06.2019, punët do të duhej të përfundonin brenda 60 ditë, ndërsa punimet ende nuk kishin përfunduar apo ishin në vonesë shtatë muaj; dhe</li> </ul>		<p>pika 30.6 i rregullave dhe udhëzuesi operative i prokurimit publik i vlefshëm nga data 10.04.2019</p>			
--	--	--	--	--	--	--	--



		<ul style="list-style-type: none"> <li>Në kontratën "Blerja e pajisjeve mjekësore për QKMF, QMF" kontratë e lidhur me datë 19.07.2019 në vlerë 56,130€, pranimi furnizimeve ishte parapara në kontratë të bëhej brenda 30 ditëve, ndërsa furnizimi i tyre ishte bërë me 30.10.2019 me dy muaj vonesë. Për këtë kontratë nuk na është ofruar donjë sqarim nga komuna se pse ishin vonesat e tilla.</li> </ul> <p>Sipas komunës për të gjitha projektet e lartë cekura arsyet e vonesave ishin si rezultat i prolongimeve të punimeve nga punë kryesit, për shkak të problemeve pronësore dhe</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

		<p>mospajtimin të qytetarëve me disa pozicione të punimeve të parapara nga komuna në kontratë, si dhe nevojës për ndryshime të pozicioneve. E gjithë kjo rrjedhë si pasojë e projekteve dhe specifikimeve teknike jo të duhura nga ana e komunës dhe mos përshtatja e tyre me kushtet në teren.</p> <p>Për më tepër komuna nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit të projekteve të lartcekura për të mbuluar vonesat në realizim të punimeve.</p>					
7.	<p><b>Çështja A4 –</b> Mos njoftimi i AQP-së për procedurat e jashtë planit të prokurimit</p>	<p>Sipas nenit 9.6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nëse aktivitetet e prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të autoritetit</p>	<p><b>Rekomandimi A4</b></p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive</p>	<p>Ne në vijim do të forcojm kontrollin që aktivitetet e prokurimit të cilat për arsye të ndryshme ose projektet</p>	<p>-Zyrtar autorizues për autorizimin e inicimit të prokurimit i njësive të kërkesave .</p> <p>-Zyrtari</p>	<p>Faza e parë: Fillimi i zbatimit të jetësimit të rekomandimeve nga muaji Gusht 2020</p> <p>Faza e përfundimit</p>	

	<p>kontraktues, ZKA do të dërgojnë AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit.</p> <p>Komuna në planin e prokurimit nuk kishte përfshirë të gjitha aktivitetet apo projektet e planifikuara, ajo kishte zhvilluar procedurat e tenderimit jashtë planit të prokurimit duke mos e njoftuar AQP-në për dy (2) projekte dhe atë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Projektin "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi në</li> </ul>	<p>kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet e planifikuara. Njëherit ku rparaqiten nevoja përblerje jashtë planit duhet të vendosen mekanizma për njoftim paraprak të organeve relevante sipaskërkesave ligjore.</p>	<p>kan qen të planifikuar në vitin më parë të veprj sipas pikës 8.6 të Rregullës për UOPP. Tutje nëse aktiviteti i prokurimit nuk ishte përfshirë në planifikimin final të prokurimit, një kopje e formularit do të dërgohet nga ZKA- të tek AQP –ja të paktën 5 ditë para autorizimit nga Zyrtari autorizues të zyrtarit të prokurimit për të iniciuar aktivitetin e prokurimit. Kjo bëhet në mënyrë që AQP-ja të identifikoj çdo artikull të</p>	<p>përgjegjës i prokurimit.</p> <p>-ZKF për konfirmimin se mjetet janë autorizuar alokuar dhe zotuar për projektet që planifikohen të fillojnë procedurat e prokurimit.</p>	Dhjetor 2020	
--	---	--	--	---	--------------	--

		<p>Suharekë-Faza e parë" me vlerë prej 747,897€, dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Projektin "Ndërtimi i rrugës Ngucat-Javord" me vlerë 162,961€.</li> </ul> <p>E gjithë kjo ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur profesional të zyrtarëve përgjegjës në respektimin e kritereve të përcaktuara në ligj.</p>		<p>përdorimit të zakonshëm që mund të blihet në mënyrë më efektive përmes procedurës së prokurimit të përbashkët. Gjetjet e konstatuar janë të pakta për këtë proces.</p>			
8.	<p><b>2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale</b></p> <p><b>Çështja C2 – Parregullsi në menaxhimin dhe shpalosjen e pasurive në PFV</b></p>	<p>Sipas nenit 6 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Po ashtu, regjistri i pasurive duhet të përfshijë</p>	<p><b>Rekomandimi C2</b></p> <p>Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informativ në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit</p>	<p>Edhe pse kontrolli në këtë fushë ka treguar një progres të mjaftueshëm të gjitha vërejtjet janë adresuar për shkak të situatës së krijuara të pandemisë. Vlen të theksohet se</p>	<p>-Zyrtari për menaxhimin e pasurive</p> <p>-Zyrtari shpenzues</p> <p>-Zyrtarët e Logjistikes të angazhuar në organizatën buxhetore dhe me theks të</p>	<p>Data e fillimit dhe përfundimi deri në</p> <p>Janar shkurt 2021</p>	

		<p>pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqe tnë E-pasuri. Mëtuftje, neni 19, pika 4.7, për cakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV-ve.</p> <p>Lidhur me testet tona ne kemi konstatuar si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë. Nga mostrat e testuara ne kemi identifikuar 10 pagesa me vlerë prej 183,225 € të cilat nuk ishin përfshirë në regjistrin SIMFK; dhe</li> <li>• Pasuria nën 1,000€ e</li> </ul>	<p>duhet të siguroj që raporti i inventarizimit merret nëkonsideratë para përgatitjessë PFV.</p>	<p>opinionit për pasqyrat financiare për vitin 2018 ka qen me thekës të çështjes për pasurit për deri sa ne vitin 2019 për shkak të një progresi të shtuar opinionit me theks të çështjes nuk është për pasurit.</p> <p>Edhe për kundër një progresi në vijim do të forcojmë kontrollin në jetësimin dhe adresimin e të gjitha gjetjeve aq sa lejojnë situata e përhapjes së pandemisë.</p>	<p>veçant zyrtarët e angazhuar në arsim dhe shëndetësi.</p>		
--	--	--	--	---	---	--	--

		<p>prezantuar në PFV nuk ishte e plotë. Vlera e pasurive e integruar në regjistrin e-pasuria ishte në vlerë prej 781,106€, ndërsa vlera prej 780,306€ ishte dërguar në MAP për integrim pas përgatitjes së PFV të vitit 2019.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit dhe kontrollit jo të mire nga personat përgjegjës, për të harmonizuar pagesat dhe regjistrimet nëregjistra përkatës.</p> <p>Po ashtu, komisioni i inventarizimit tëpasurisë në komunë, nuk kishte arritur të përfundoj raportin para përgatitjes së PFV.</p> <p>Komisioni raportin e kishte përfunduar me datën 21.05.2020 dhe rrjedhimisht</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		asnjë rezultat i inventarizimit nuk është reflektuar në PFV.					
9.	<b>2.3 Të arkëtueshmet</b>  <b>Çështja B3 – Sfidat në menaxhimin e të arkëtueshmeve</b>	Në kontratat e lidhura nëmes të komunës dhe qiramarrësve janë paraparë masat që duhet të ndërmarrën në rast të mos pagesës së qirasë si pas kritereve të përcaktuara në kontratë. Më tutje, në nenin 3 të kontratave, ishte specifikuar që kontratat të ripër tërihet çdo vit për shkak të një monitorimi më të mirë, megjithatë ato nuk ishin ripërtërirë.  Nga testimi 11 kontratave për shfrytëzimin e pronës publike, identifikua se, për shkak të mos pageses mujore apo vjetore nga qiramarrësit sipas kontratave, komuna nuk kishte arritur t'i	<b>Rekomandimi B3</b>  Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduar bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.	Ne në vijim dhe në bashkëveprim edhe me Drejtorinë e pronës e cila dhe është kompetente për menaxhimin e kontratave do ta forcojmë kontrollin i dizajnuar në zvogëlimin e të arkëtueshmeve të cilat janë edhe të bartura nga vitet tjera Tutje do të fillojmë me ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme në vjeljen e detyrimeve nga qiraja aq	Drejtoria e pronës dhe zyrtar tjerë të angazhuar në sistemin e menagjimit të kontratave të nënshkruar dhe ndërmarrjen e veprimeve për inicimin e procedurave për dhënie të pronave me qira.	Afati i fillimit gusht 2020 dhe afat përfundimi Gusht 2021	

		<p>arkëtojë të hyrat nga borxhi i akumuluar në vlerë totale prej 155,776€.</p> <p>Në gjashtë kontrata prej 11 kontratave të cekura më lartë, afati kohor i kontratave kishte skaduar, ndërsa ato nuk ishin rippërtërirë. Madje ngarkesa vjetore ishte bërë duke u bazuar në kontratën paraprake. Arsyeja e mos vazhdimit të kontratave ishin problemet pronësore dhe objektet shumë të vjetra dhe se sipas zyrtarëve përgjegjës të komunës pas miratimit të planit zhvillimor komunal do të definohet edhe statusi i këtyre pronave.</p>		<p>sa na lejon situata e krijuar e përhapjes së pandemisë dhe stafit të reduktuar si dhe gjendjes se vështirë të bizneseve që operojnë në komunën ton.</p> <p>Drejtoria e pronës edhe përkundër një progresi të lidhjeve të kontratave të reja dhe një numri i kontratave është në proces do të fillojmë me procedura menjëherë që qiramarrësit që shfrytëzojnë pronën komunale të cilat nuk kanë ndonjë pengës ligjore me kontratë</p>		
--	--	--	--	---	--	--



				të skaduar në pajtueshmëri me Ligjet e aplikueshme të i legalizojmë me kontrata të reja duke aplikuar procedurat konkurruese.			
10.	<p><b>2.4.1 Detyrimet e papaguara</b></p> <p><b>Çështja B4</b>– Vonesa në realizimin e pagesave të obligimeve.</p>	<p>Sipas nenit 39.1 të li gjit Nr.03/L-048 për MFPP që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pages për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen Brenda tri dhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.</p> <p>Nga 5 mostrat e testuara ka rezultuar se të gjitha faturat me vlerë të përbashkët 37,881€, nuk ishin</p>	<p><b>Rekomandimi B4</b></p> <p>Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe te vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha afaturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'ikryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej</p>	<p>Ne në vijim do të forcojmë kontrollin me të gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore që në vijim mos të hyjnë në obligime pa siguruar paraprakisht fonde të mjaftueshme. Po ashtu nuk do te lejohet asnjë autorizim për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit</p>	<p>Të gjithë njësite e programeve buxhetore.</p>	<p>Data e fillimit TM 3 2020</p> <p>Data e përfundimit TM 1 2021</p>	

		<p>paguar brenda afatit të paraparë ligjor. Vonesat ishin duke filluar nga 55 ditë e deri në 5 muaj, përtej afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh. Kjo ka ndodhur në mungesë të zbatimit në tërësi të rregulloreve për shpenzimin e parasë publike nga zyrtarët përgjegjës. Si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë, për vitin 2019 ishin ekzekutuar pagesa direkt sipas vendimeve të Gjykatës Themelore në vlerë 178,315€.</p>	30 ditëve.	<p>dhe mos të nënshkruhet asnjë kontratë pa u siguruar fonde të mjaftueshme.</p> <p>Po ashtu alokimi i buxhetit për tremujorin e parë të vitit 2021 të mos shpenzohet pa u përmbuar të gjitha të pagueshmet e bartura .</p>			
--	--	---	------------	---	--	--	--

Duke marrë në konsiderate Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të Veprimit.

Së bashku me Kryesuesin e Kuvendit të komunës do të harmonizojmë agjendën e takimit për shqyrtimin e Raportit të Auditimit në mbledhjen e radhës së Kuvendit dhe shqyrtimin e planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve.

- Deri në fund të muajit janar 2021, do të diskutoj në Kuvendin e Komunës për progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2020 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Transereve;
- Po ashtu, në kohë reale do të dorëzojmë Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.
- Me planin e veprimit të njoftohen të gjithë bartësit të autorizuar për adresimin e rekomandimeve në formë elektronike.

**Veprimet e Kryetarit të komunës dhe ndermarrja e veprimeve në adresimin e rekomandimeve janë si në vijim:**

**Njoftohen dhe obligohen të gjithë bartësit e përcaktuar që menjëherë të fillojnë me përcjelljen e implementimit të procedurave të projektuar për adresimin e tërësishëm të rekomandimeve sipas afateve të caktuar në planin e veprimit të Menaxhmentit.**

**Për mënyrën, afatin e jetësimit të rekomandimeve të gjithë bartësit e përcaktuar janë të obliguar më kohë dhe në mënyrë të detajuar në formë të shkruar të na raportoni.**

**Ne në vijim do të vlerësojmë ecuritë e progresit dhe dobësitë eventuale sipas periudhave tremujore. Pos raportimeve më shkrim do t'i zbatojmë procedurat e vetëvlerësimit lidhur me progresin e arritur dhe do t'i identifikojmë dobësitë që kanë rezultuar në mos adresimin e rekomandimeve dhe vendosjen e kontrollave dhe mekanizmave efikase të adresimit të plotë të rekomandimeve.**

**Moszbatimi eventual i rekomandimeve të përcaktuar si më lartë në planin e veprimit të Menaxhmentit përgjegjësia bie mbi bartësit.**

Suharekë datë ; 10/08/2020

Kryetar i Komunës

Bali Muharremaj

